



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



2718
01/Nr. ____/2025
Data: 22.04.2025

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tretë të -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 20.03.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Përfaqësuesi i OSB-së, **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
3. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.
4. Propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
5. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/9541/2024 për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.
6. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.
8. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rendit të punës kërkoj që të votohet propozim vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr. 9697 /2021 për përbërjen e Komitetit për Komunitete në Komunën e Hanit të Elezit. Propozim vendimin në fjalë e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
3. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.
4. Propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
5. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/9541/2024 për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.
6. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.
8. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
9. Plotësim ndryshimin e vendimit me numër .01/Nr. 9697 /2021 për përbërjen e Komitetit për Komunitete në komunën e Hanit të Elezit
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2.Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- plani i ka kaluar të gjitha proceduar është shqyrtuar në Komitet për Politikë e Financa, në Kuvend të Komunës pastaj në debat publik dhe është përcjell përsëri në Kuvend për Miratim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI NDËR KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJIT

3. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- komuna jonë ka përfunduar planin zhvillimorë për vitin 2025-2033. Për ndryshe hatrimi i planit zhvillimorë i komunës është obligim ligjorë duke u bazuar në ligjin për planifikim hapësinorë 04/L-174. Në muajin gushtë të vitit të kaluar Draft Planin Zhvillimorë është dorëzuar në Ministri të Planifikimit Hapësinorë për vlerësim të ligjshmërisë dhe pajtueshmërisë me planin hapësinorë të Kosovës me qëllim të marrjes së pëlqimit për hapjen e debatit publik të planit zhvillimorë. Pas katër vlerësimeve të planit zhvillimorë nga komisioni për vlerësim i Ministrisë së Mjedisit na është dhënë pëlqim për hapjen e debatit publik. Përveç kësaj edhe Kuvendi i Komunës duhet të merr vendim për hapjen e debatit publik sepse kështu kërkohet me Ligj. Pas debatit publik draft plani zhvillimorë përcillet për në Ministri dhe pas marrjes së pëlqimit final nga Ministria plani zhvillimorë kthehet në Kuvend për marrje të vendimit për miratimin e planit zhvillimorë. Propozim vendimin e keni dhe po ashtu e keni edhe draftin e planit zhvillimorë.

Sherif Berisha thekson:- shqetësuese është se pse nuk është bërë hartimi këtij plani më herët por gjashtë vite me vonesë dhe si kemi punuar deri tash.

Nexhmedin Daci thekson:- këtë çështje e kemi diskutuar edhe në Komitet për Politikë e Financa dhe është e vërtetë që ka pasur vonesa në hartimin e Planit Zhvillimorë Komunal por ju e dini që në vitin 2020, 2021 dhe një pjesë në vitin 2022 ka qenë Kovid dhe ka qenë e pa mundur mbajtja e diskutimeve publike. Kur është filluar hartimi i Planit Zhvillimorë e kemi angazhuar z.Sami Stagova si ekspert i jashtëm, mirëpo ai për shkaqe objektive të sëmundjes nuk ka mundur dhe janë bërë vonesat të mëdha. Vitin e kaluar jam detyruar për me i angazhuar edhe dy përfaqësues të jashtëm. Vitin e kaluar e kemi dorëzuar draftin në Ministrin përkatëse dhe pas prezantimit na i kanë dhënë katër herë komentet dhe është dashur me i bërë ndryshimet. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR HAPJEN E DEBATIT PUBLIK PËR DRAFT PLANIN ZHVILLIMORË TË KOMUNËS SË HANIT I ELEZIT 2025-2033.

4. Propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- zyrtarët e institutit të trashëgimisë natyrore dhe zyrtarët e komunës tetë muaj kanë punuar në teren dhe ato kanë përzgjedhur disa vlera monumentet të trashëgimisë natyrore dhe më në fund kanë propozuar pesë vlera të trashëgimisë natyrore për marrje në mbrojtje ligjore dhe ato vera janë: Parku dhe Ujëvara në Han të Elezit-monument natyrore me karakter hidrologjikë, Kanioni në Dromjak-monument natyrore me karakter hidrologjikë, Trugu i Bungëbutes (*Quercus pubescens*) në Dromjak - monument natyrore me karakter botanik, Trugu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) në Gorancë- monument natyrore me karakter botanik, Kepi i gjatë dhe burimi i ujit në Pustenik -monumet natyrore me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjikë. Me material e keni elaboratin e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe raportin nga instituti për mbrojtjen e natyrës. Sipas legjislacionit duhet të del në debat publik dhe pas debatit publik duhet të hartohet një raport i debatit publik dhe pastaj të kërkohet pëlqim prej Ministrisë përkatëse për futje në marrje në mbrojtje ligjore të këtyre monumenteve të trashëgimisë natyrore dhe përsëri dokumentacioni kthehet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Refet Kalisi thekson:- është potencuar parku dhe ujëvara por kërkoj sqarim se për cilën ujëvarë bëhet fjalë

Nexhmedin Daci thekson:-bëhet fjalë për ujëvarën te stacioni i policisë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË STUDIMEVE DHE EVIDENTIMIT TË VLERAVE TË TRASHIGIMISË NATYRORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT TË PROPOZUARA NGA INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

5. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/9541/2024 për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- kërkoj që të anulohet vendimi për këto ndërtesat e vjetra, me qenë se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal na e ka kthyer përgjigjen shumë të pa qartë se nuk kemi kërkuar nga ata se a i kanë blerë, a i kanë shitur apo a i kanë privatizuar, a janë të regjistruar në kadastër por kemi kërkuar se a ju mundësohet këtyre pronarëve me bërë ndërtime në ato parcele por nuk kanë kthyer përgjigje decitive por kanë kërkuar që mirë është me tërhequr derisa të miratohet ligji kështu që jemi me një pozicion jo të qartë dhe mirë është me anuluar këtë vendim deri sa të krijohen kushtet ligjore për investim në ato ndërtesa.

Sherif Berisha thekson:- vërejtje kam në këtë drejtim për arsye se ne kemi zyre ligjore dhe nuk e di pse është sjell me u votuar në kuvend dhe tash me e shfuqizuar pra është e paqartë se pse nuk bashkëpunoni në këtë drejtim që mos me na u dërguar në kuvend me votuar diçka që po na i krijon këto situata tash.

Nexhmedin Daci thekson:- unë mendoj se ky vendim është plotësisht i drejtë, do të shihet e do të bindeni edhe ju vetë se ky vendim është i drejtë por tani unë nuk mundem me i komentuar qëndrimet e zyrtarëve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Këtë çështje e kemi diskutuar me zyrën ligjore dhe me Kryetarin e Komunës kemi qenë në Ministri dhe ata kur i shohin këta ndërtesa të gjithë pajtohen por nuk e prejnë këtë punë dhe nuk e di për çfarë arsye, për ndryshe nuk ka kuptim dhe nuk ka askund në botë që shtëpia me qenë e jotja dhe toka me qenë e dikujt tjetër për shkak se në momentin që e blenë një shtëpi ki blerë edhe tokën mbi të cilën qëndron ajo shtëpi. Dy ligje janë në Kuvendin e Kosovës të cilët kanë kaluar në lexim të parë që është Ligji i Tokës Ndërtimore dhe Ligji i Banimit Kolektiv dhe në bazë të atyre ligjeve pronarët e këtyre banesave kanë mu bërë bashkë pronarë të asaj parcele dhe besojmë thellësisht se ky vendim është i drejtë.

Sherif Berisha thekson:- ata që e potencuat ju dhe ajo që na është dërguar neve janë ndeshë njëra me tjetrën, tash ju potenconi që kemi drejtë, ndërsa prej Ministrisë na është dërguar në këtë mënyrë kërkoj sqarim se cila është e drejta.

Nexhmedin Daci thekson:- ju e keni materialin dhe nëse e keni lexuar e shihni se a kemi pyetur na se si me bërë shitjen, a janë të regjistruar në kadastër por pyetja ka qenë se a kanë të drejtë këto me bërë ndërtim dhe nuk janë përgjigjur.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër.

MIRATOHET SHFUQIZIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/9541/2024 PËR NDËRTE SAT E VJETRA KOLEKTIVE TË CILAT JANË NË ZONËN URBANE

6. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:- gjatë vitit 2024 janë mbajtur afër dymbëdhjetë mbledhje dhe të gjitha mbledhjet kanë shkuar në rregull, shumicën e pikave i kemi shqyrtuar dhe jemi munduar me dhënë kontribut edhe në Kuvend. Vërejtje të vogël e kemi pasur që ka pas raste që kanë munguar drejtorët ose drejtoreshat. Përveç materialit të cilin e kemi përcjellë diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024

7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- informatën për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024 e kemi diskutuar edhe në Komitet për Politikë e Financa. Në material janë paraqitur çështjet të cilat janë diskutuar në Këshillin për Siguri në Bashkësi pra janë diskutuar temat të cilat janë planifikuar sipas planit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- para juve keni informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024 pra është bërë një raport i përgjithshëm dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Resul Suma thekson:- a është rregulluar çështja e pagesës për Kryetarët e Këshillave të fshatrave.

Natyra Kalisi thekson:- nuk di që ka pasur ndonjë telashe dhe mëditjet për vitin 2024 janë kryer ndërsa për vitin 2025 akoma nuk kemi filluar me mbledhje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr. 9697 /2021 për përbërjen e Komitetit për Komunitete në komunën e Hanit të Elezit

Kryesuesi thekson:- duhet të bëhet plotësim ndryshimi, ndërsa emrin do ta përcjellim ndërkohë në sekretari. Plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr. 9697 /2021 për përbërjen e Komitetit për Komunitete në komunën e Hanit të Elezit e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.9697/2021 PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- pse nuk është shpallur konkurs për drejtor të shkollës dhe për drejtor të QKMF-së. Ku është duke punuar niveli qendrorë në komunën tonë.

Hisni Luri thekson:- drejtori i shkollës ka mandat ende dhe pas skaduar mandati nuk mund të hapet konkursi dhe procedurat e reja të Ministrisë janë që konkurs mundemi mos me hapur dhe inspektorati e bënë vlerësimin.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- për drejtor të QKMF-së konkursi është i hapur dhe po presim që të aplikojnë kandidatët.

Mehmet Ballazhi thekson:- komuna e Hanit të Elezit është duke punuar dhe është duke i përmbyllur projektet të cilat i ka në vazhdim. Qeveria nuk është tu punuar por është një kompani që ka qenë e kontraktuar edhe më herët dhe është duke i kryer punimet te vendi i quajtur “Te e Shemta”.


Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:32.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

